



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 397 Akti

Nr. 551 Vendimi
Tiranë, më 13.07.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja Kryesuese
Pamela Qirko Relatore
Roland Ilia Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 13.07.2022, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arjan Aliaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit kalimtar.**

BAZA LIGJORE: **Neni G i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “a” e pikës 1 të nenit 64 dhe neni 65 i **ligjit nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dokumentacionin, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arjan Aliaj, gjatë periudhës së procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 20.12.2019, vendosi fillimin e një hetimi administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Kryesues i trupit gjykues u zgjodh me mirëkuptim komisionere Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.

4. Në datën 27.2.2020 subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike¹ mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u njoh me përbërjen e trupit gjykues, si dhe iu kërkua të deklaronte konfliktin e interesit me anëtarët e tij.

5. Në datën 8.2.2022, subjekti i rivlerësimit deklaroi² mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues, si dhe iu përgjigj pyetësorit të parë.

6. Në vijim, gjatë procesit të hetimit administrativ, në datën 18.5.2022, subjekti paraqiti pranë Komisionit kërkesë³ për pezullim hetimi administrativ deri në shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë nga statusi i magjistratit, duke paraqitur njëkohësisht kopje të kërkesës drejtuar KLGJ-së në datën 18.5.2022, me objekt heqje dorë nga statusi i magjistratit.

¹ E-mail i datës 27.2.2020 “Njoftimi i trupës gjykuese dhe Pyetëtori 1”.

² Nëpërmjet postës elektronike të datës 8.2.2022.

³ Protokolluar me nr. *** prot., datë 18.5.2022.

7. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të kërkesës, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 66, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative, vendosi⁴ pezullimin e hetimit administrativ për rivlerësimin e subjektit deri në përfundimin e procedurës ligjore, parashikuar në ligjin nr. 96/2016, në lidhje me trajtimin e kërkesës për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

8. Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2022⁵, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka komunikuar Komisionit vendimin nr. ***, datë 16.6.2022, me të cilin ka vendosur miratimin e kërkesës për dorëheqje të gjyqtarit Arjan Aliaj, duke deklaruar mbarimin e statusit si magjistrat, vendim i cili i është komunikuar gjithashtu subjektit të rivlerësimit.

9. Në vijim, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike të datës 6.7.2022 për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore, për të shprehur vullnetin e tij të pavesuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁶

10. Kolegji i Posaçëm Apelit, në lidhje me praktikën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

11. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

12. Në përgjigje të shkresës së Komisionit, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2022, informon se subjekti Arjan Aliaj nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 16.6.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

c. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

13. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe në kuptim të garancive ligjore që gëzon subjekti i rivlerësimit në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me anë të postës elektronike⁷, njoftoi subjektin se dorëheqja gjatë procesit të rivlerësimit bazohet në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“(i) subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i*

⁴ Me vendimin nr. 2, datë 19.5.2022.

⁵ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.6.2022.

⁶ Vendimi Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, paragrafët 96 dhe 97.

⁷E-mail, datë 6.7.2022

rivlerësimit ndërpritet; (ii) subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare” dhe, për këtë arsye, i kërkoi subjektit të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin mbi dorëheqjen nga statusi i magjistratit në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.

14. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, në datën 8.7.2022, deklaroi se nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe se nuk heq dorë nga kërkesa për dorëheqje paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

d. Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit

15. Në germën “a”, pika 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

16. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

17. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

18. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

dh. Arsyetimi ligjor i fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18. Bazuar në faktet e sipërcituara, në bazën ligjore përkatëse, në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në lidhje me konfirmimin e vullnetit të lirë dhe të pavesuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, si dhe

duke qenë se:

- i. subjekti i rivlerësimit Arjan Aliaj ka kërkuar deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes nga statusi;
- ii. Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka miratuar kërkesën e subjektit dhe ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit Arjan Aliaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- iii. subjekti i rivlerësimit nuk e ka ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vendimin nr. ***, datë 16.6.2022, të KLGJ-së;
- iv. Komisioni kërkoj konfirmimin e shprehjes së vullnetit të subjektit, në lidhje me dorëheqjen nga statusi i magjistratit, si dhe e vuri në dijeni për pasojat që vijnë nga kjo dorëheqje sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës;
- v. subjekti i rivlerësimit konfirmoi me *e-mail* se nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe se nuk heq dorë nga kërkesa për dorëheqje paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Trupi gjykues vlerëson se konfirmohet vullneti i plotë dhe i pavesuar i subjektit të rivlerësimit për dorëheqje.

19. Trupi gjykues i Komisionit çmon se referuar fakteve të të paraqitura më lart, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjan Aliaj duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

20. Për sa më sipër, në referim të germës “b”, të nenit 89 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

21. Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin Arjan Aliaj duhet ndërprerë sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, bazuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në germën “b” të nenit 89 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Arjan Aliaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Arjan Aliaj, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 13.07.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA

Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi